

NJOFTIM

Njoftojmë se më datë 28.02.2013 do të zhvillohet ceremonia për vendosjen e eshtrave të dëshmorëve të Atdheut Besnik Hidri dhe Leka Qokaj, në varrezat e dëshmorëve Tiranë.

Besnik Hidri e Leka Qokaj kanë qënë punonjës të Shërbimit Informativ dhe më 28.02.1997 kanë rënë në krye të detyrës, për mbrojtjen e institucioneve shtetërore, në Vlorë.

Me dekretin Nr. 4152, datë 25.02.2004 të Presidentit të Republikës, Besnik Hidri dhe Leka Qokaj janë dekoruar me “Medaljen e Shqiponjës së Arte” (pas vdekjes) me motivacionin: ”Në shenjë nderimi dhe vlerësimi të lartë për veprimtarinë dhe kontributin e vyer në shërbim të shtetit, deri në aktin sublim, dhënien e jetës në krye të detyrës”.

Besnik Hidri dhe Leka Qokaj janë shpallur dëshmorë të Atdheut me vendim Nr. 62, datë 29.06.2006 të Komisionit të Posaçëm Qeveritar.

Ceremonia do të nisë me homazhet në orën 11.⁰⁰ në Qendrën Kulturore të Ushtrisë, Tiranë, të cilat do të vazhdojnë deri në orën 12.⁰⁰.

Më pas, arkivolet me eshtrat e dëshmorëve Besnik Hidri e Leka Qokaj do të lëvizin për në varrezat e dëshmorëve, Tiranë.

Në ceremoni janë ftuar të marrin pjesë personalitete të larta të shtetit, familjarë, të afërm, ish kolegë, shokë e miq të dëshmorëve Besnik Hidri e Leka Qokaj.

Shërbimi Informativ i Shtetit.

Tiranë, më 26.02.2013